URDHËR
Nr. 23, datë 30.10.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të nenit 102, të pikës 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar; të vendimit nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar; të vendimit nr. 870, datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit"; të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", të ndryshuar; të vendimit nr. 243, datë 15.5.1995, të Këshillit të Ministrave, "Për shpenzimet për pritjen, përcjelljen dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja", të ndryshuar; si dhe të udhëzimit nr. 22, datë 10.7.2013, të ministrit të Financave, "Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit",

URDHËROJ:

1. Delegimin te Sekretari i Përgjithshëm të kompetencës për lëshimin e autorizimeve për përfaqësim ligjor të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, në proceset gjyqësore ku ministria thirret si palë në gjykim, apo si subjekt i interesuar. Modeli i autorizimit është sipas lidhjes nr. 1 të këtij urdhri.
2. Delegimin te Sekretari i Përgjithshëm të kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimit publik, për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit.
3. Delegimin te Sekretari i Përgjithshëm të kompetencave për nënshkrimin e urdhrave për shërbimet jashtë vendit për nëpunësit e aparatit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, si dhe nënshkrimin e program-urdhrave për aktivitetet zyrtare për pritjen dhe përcjelljen e delegacioneve të huaja të zhvilluara brenda dhe jashtë institucionit, pas miratimit të kërkesave nga titullari i institucionit.
4. Delegimin e kompetencave Sekretarit të Përgjithshëm, për të autorizuar dërgimin me shërbim të punonjësve të Aparatit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, jashtë qendrës së punës, brenda vendit, me largësi mbi 100 km.
5. Delegimin te Sekretari i Përgjithshëm të kompetencave për nënshkrimin e kontratave të punës, si dhe aktet për përfundimin e marrëdhënies së punës, për pozicionet e punës që rregullohen me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, si dhe kryerjen e të gjitha veprimeve administrative dhe procedurale në zbatim të tyre.
6. Kompetencat e deleguara në këtë urdhër mbarojnë me shfuqizimin e këtij urdhri, ose me pushimin e ekzistencës së organit delegues, apo të deleguar.
7. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, si dhe nëpunësit e aparatit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit për zbatimin e këtij urdhri.
8. Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri shfuqizohet çdo urdhër tjetër që bie në kundërshtim me të.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË DHE INOVACIONIT
Delina Ibrahimaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE E PËRPUTHSHMËRISË

Nr._____ Prot. Tiranë, më ____.____.2025

A U T O R I Z I M
(Për përfaqësim në proceset gjyqësore)

GJYKATËS _____

Në mbështetje të neneve 64–77 të Kodit Civil, neneve 92 e 96 të Kodit të Procedurës Civile, të ndryshuar dhe urdhrit nr. ___ datë ___.___.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm "Për delegimin e kompetencave"

V E N D O S A:

Autorizimin e juristit/juristëve _____,pranë Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë, për të realizuar përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, në mbrojtje të interesave të saj, së bashku ose veç e veç dhe nënshkrimin e akteve/mjeteve procedurale në lidhje me çështjen gjyqësore _____, me palë ndërgjyqëse, si më poshtë:

Paditës: _____

I paditur: _____

Objekti: _____

SEKRETAR I PËRGJITHASHËM

Suzana Hoxha